



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 31 prot.

Kamëz, më 11.3.2022

V E N D I M

Nr. 27 Datë 11.3 2022

MBI

**“ MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE TË CILËT PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE, (PALLATET E VALIASIT) TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019 “**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 11.03.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.24 Datë 7.03.2022** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”; Aktin Normativ nr. 09 datë 16.12.2019 “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ” dhe aktet nën-ligjore për zbatim të tij; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar; Vendimin Nr. 904, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit ”; Vendimin Nr.5, datë 06.01.2020 “ Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model ”; Vendimin Nr.8, datë 06.01.2020 “ Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje ”; Vendimin Nr. 887, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore ”; Vendimin nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “ Përmiratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit ”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për objektet kolektive, (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt-ekspertizat e thelluara nga Instituti i Ndërtimit me nivel dëmtimesh “ Për Shembje ”. (FAZA IV)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Emergjencave Civile dhe Strehim, Drejtorja e Çështjeve Ligjore, Drejtorja e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit, Drejtorja e Financës dhe Kontabilitetit, dhe Drejtorja e Rindërtimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli

Hysen Koldashi

